



Pranuar / Dorezuar Pamflet / Protokol Received / Delivery	05 - 10	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTIK	5901/2022		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.722/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.722/2021 të datës 22.08.2022, të parashtruar nga ankuesit Dardan Krasniqi dhe Shpëtim Mehmeti e regjistruar në Këshill në emër të me adresë banimi:

kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 05.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet **jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.722/2021 të datës 22.08.2021, të parashtruar nga ankuesit dhe

A r s y e t i m

Ankuesit dhe Shpëtim Mehmeti, të cilët sipas shkresave të lëndës janë të punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 22.02.2022 kanë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se Njësia e Burimeve Njerëzore është duke vepruar në mënyrë të kundërligjshme pasi që të njëjtëve nuk po u lëshohen akt emërimet me rastin e ristrukturimit të institucionit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.08.2022, ankesën e ankuesve e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa me datë 02.09.2022 Njësia Përgjegjëse e MPJD-së ka përcjell provat e kërkuara të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesve të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës me numër protokollit 4865/2022 të datës 22.08.2022 me shkresat e bashkangjitura; Plotësimin e ankesës të datës

02.09.2022 me numër protokolli:5107/2022; Kontratën e punës së ankuesit Shpëtim Mehmeti të datës 02.05.2009; Kontratën e punës së ankuesit të datës 26.01.2009; E-mailin e datës 25.10.2010 dërguar nga E.H për A.Z; Rekomandimin e datës 29.10.2010 për përsëritjen e kontratës së punës; Kontratën e punës së ankuesit të datës 25.01.2011; Rekomandimin e datës 10.12.2010 për përsëritjen e kontratës së punës; Akt emërimit e ankuesit të datës 05.09.2012; Akt emërimit e ankuesit të datës 05.09.2012; Vendimin e datës 08.09.2014 me numër: ZSP/143/14; Vendimin e datës 08.09.2014 me numër: ZSP/146/14; Ndryshimin dhe Plotësimin e aktit të emërimit nr.41/2012 të ankuesit i datës 12.09.2014; Ndryshimin dhe Plotësimin e aktit të emërimit nr.40/2013 të ankuesit i datës 15.09.2014; E-mailin e datës 11.03.2022 dërguar nga Arkiva MPB për ankuesin Sh.M; Vendimin e datës 10.05.2022 me numër:79/2022 lëshuar nga DMZP; E-mailin e datës 11.03.2022 dërguar nga Arkiva MPB për ankuesin D.K; Vendimin e datës 10.05.2022 me numër:46/2022 lëshuar nga DMZP; Kërkesën e ankuesve të datës 20.07.2022 drejtuar Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MPJD-së; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 30.08.2022; Përgjigjen në kërkesë të datës 02.09.2022; E-mailin e datës 01.09.2022 dërguar nga V.B për ankuesit; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Asistent i transportit/voztës; E-mailin e datës 02.09.2022 dërguar nga V,B për Këshillin.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstatoi se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ***nuk është kompetent*** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit dhe ***sepse:***

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në provat e lëndës, respektivisht Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit me numër:41/2012 të datës 12.09.2014 ka konstatuar se ankuesi Shpëtim Mehmeti mban pozitën e punës "*asistent i transportit/voztës*" në kuadër të MPJ/Divizioni për IT dhe Logjistike, ndërsa me rastin e ristrukturimit të institucionit përmes Vendimit të datës 10.05.2022 me numër:79/2022 Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik ka vendosur që ankuesi të transferohet në pozitën e njëjtë "*asistent i transportit/voztës*" në Divizionin për Logjistike dhe Shërbime-Departamenti për Shërbime të Përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, dhe po ashtu sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit me numër:41/2012 të datës 12.09.2014 ka konstatuar se ankuesi mban pozitën e punës "*asistent i transportit/voztës*" në kuadër të MPJ/Divizioni për IT dhe Logjistike, ndërsa me rastin e ristrukturimit të institucionit përmes Vendimit të datës 10.05.2022 me numër:79/2022 Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik ka vendosur që ankuesi të transferohet në pozitën e njëjtë "*asistent i transportit/voztës*" në Divizionin për Logjistike dhe Shërbime-Departamenti për Shërbime të Përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, kurse sipas përshkrimi detyrave të punës për pozitën "*asistent i transportit/voztës*" është e përcaktuar kategoria funksionale: *administrativ-teknik, me detyra: "1. Ofrimin e shërbimeve për zyrtarët që kërkojnë transport-voztje,"*.

Lidhur me pranueshmërinë dhe kompetencën e shqyrtimit të ankesës së ankuesve, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 2 ku përcaktohet se: 3. ***Nëpunës civil*** - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë: 6. ***Nëpunës administrativo-teknik*** - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, voztjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike" dhe si rrjedhojë duke u bazuar në përshkrimin e detyrave të punës të ankuesve, Kolegji ka konstatuar se pozita "*voztës*" hynë në kategorinë e nëpunësve administrativo-teknik

dhe mbështetës, respektivisht ankuesit dhe nuk e kanë statusin e nëpunësit të shërbimit civil.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil si dhe duke marrë parasysh konstatimin se ankuesit kanë statusin e nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, Kolegji i Këshillit konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.722/2022 e datës 22.08.2021 të parashtruar nga ankuesit dhe

Kolegji për Shqyrtimin dhe e Ankesave, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se marrëdhënia e punës për nëpunësit administrativ dhe mbështetës i nënshtrohet legjislacionit të punës, dhe sipas 24 paragrafi 4 të këtij ligji, zyrtarët publik me status të nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.722/2022

Flakron GASHI

Zyrtare i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, dhe
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në të Ministrisë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Arkivit të KPMShCK- së.